



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 79

Tiranë – E martë, 6 maj 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 414, datë 29.4.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë.... 8515
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 415, datë 29.4.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 8515
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 416, datë 29.4.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Turqisë..... 8516
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 417, datë 29.4.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës..... 8517
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 418, datë 29.4.2025	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Greqisë..... 8518
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 419, datë 29.4.2025	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 908, datë 4.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Italisë”..... 8520
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 67, datë 8.4.2025	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV..... 8521
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 68, datë 8.4.2025	Mbi licencimin e shoqërisë “Renew” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet prodhues 2 mw..... 8522

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 8.4.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	8524
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 8.4.2025	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	8526
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 71, datë 8.4.2025	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Gega-G” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	8528
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 8.4.2025	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “5GX Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës sigurorese) të aseteve fikse të saj.....	8530
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 75, datë 14.4.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	8531
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 76, datë 14.4.2025	Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 222, datë 23.10.2024, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Hydropowerplant Construction” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj.....	8533
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 77, datë 14.4.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e transferimit nëpërmjet vendosjes së barrës sigurorese të aseteve fikse të shoqërisë “M.C. Energji Gojan” sh.a.....	8535
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 78, datë 14.4.2025	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.....	8536
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 79, datë 14.4.2025	Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”.....	8537
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 502/5, datë 30.4.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 875, datë 11.11.2020, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtimi i nënstacionit 400/110/20 kV, Tërana 3’”.....	8542



URDHËR

Nr. 414, datë 29.4.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E HUNGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- shpendëve dekorativë;
- materialit biologjik të shpendëve;
- vezëve të shpendëve;
- mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Hungarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

<i>Ndarja administrative e nivelit 1</i>	<i>* Ndarja administrative e nivelit 2</i>
<i>Heres</i>	<i>Füzesabony*</i>
<i>Békés</i>	<i>Mezőkovácsháza*</i>
<i>Csongrád-Csanád</i>	<i>Kistelek*</i>
<i>Pest</i>	<i>Cegléd*</i>
<i>Csongrád-Csanád</i>	<i>Csongrád*</i>
<i>Csongrád-Csanád</i>	<i>Hódmezővásárhely*</i>
<i>Csongrád-Csanád</i>	<i>Mórábalom*</i>
<i>Jász-Nagykanizsai</i>	<i>Szolnok*</i>
<i>Hajdú-Bihar</i>	<i>Berettyóújfalú*</i>
<i>Békés</i>	<i>Szarvas*</i>
<i>Bács-Kiskun</i>	<i>Jánoshalma*</i>

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojnë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve

të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 399, datë 23.4.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 415, datë 29.4.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- mishit të freskët;
- materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë



trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

65°C në 39.8 sekonda;

70°C në 3.6 sekonda;

74°C në 0.5 sekonda;

80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga shteti i Polonisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	*Ndarja administrative e nivelit 3
1	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2	Mazowieckie	Siedlce	Przesmyki*
3	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
4	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6	Lubelskie	Biała Podlaska	Międzyrzec Podlaski (rural)
7	Mazowieckie	Siedlce	Mordy*
8	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
9	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
10	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
11	Podkarpackie	Przemyśl	Krasieczyn*
12	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
13	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Dąbrowa Biskupia*
14	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
15	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
16	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
17	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
18	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
19	Mazowieckie	Wolomin	Tłuszcz*
20	Łódzkie	Sieradz	Wróblew*
21	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
22	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
23	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
24	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
25	Mazowieckie	Płońsk	Raciąż (rural)*
26	Małopolskie	Tarnów (City)	Tarnów*
27	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
28	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
29	Lubelskie	Kraśnik	Szastarka*
30	Podkarpackie	Krosno	Wojaszówka*
31	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
32	Łódzkie	Piotrków Trybunalski	Piotrków Trybunalski*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe

nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

3. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara në pikën 1.

5. Urdhri nr. 378, datë 16.4.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 416, datë 29.4.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E TURQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:



- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,

nga shteti i Turqisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
Konya	Çumra*
Kayseri	Kocasinan*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 382, datë 16.4.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Turqisë”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR Nr. 417, datë 29.4.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

Nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2
New York	Suffolk*
Maryland	Worcester*
Maryland	Caroline*
Maryland	Dorchester*
Colorado	Weld*
Pennsylvania	Dauphin*
Missouri	Jasper*
Missouri	Barry*
Missouri	Lawrence*
Indiana	Washington*
Indiana	Jackson*
Indiana	Adams*
California	Madera*
California	Butte*
Ohio	Auglaize*
Ohio	Van Wert*
Ohio	Greene*
North Carolina	Hyde*
Arkansas	Cleveland*
Arkansas	Clay*
Arizona	Pinal*
Illinois	Cook*
Illinois	Lawrence*
West Virginia	Pocahontas*
Florida	Hillsborough*
Mississippi	Copiah*



Mississippi	Greene*
Kansas	Doniphan*
Kansas	Rooks*
South Dakota	Miner*
South Dakota	South Dakota*
South Dakota	Charles Mix*
South Dakota	Kingsbury*
Wisconsin	Kenosha*
North Dakota	Bottineau*
North Dakota	McHenry*
Nebraska	Dodge*
Mississippi	Noxubee*
California	Merced*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 325, datë 3.4.2025, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës”, shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 418, datë 29.4.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE TË SHFAQUR NË
SHTETIN E GREQISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për Faqe| 8518

shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përjashtuar mishin në një kontejner të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-it, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Xanthi	Xanthi*	

Shënim: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Greqisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartment (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**



a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4 Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit;

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;



b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është

siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

URDHËR

Nr. 419, datë 29.4.2025

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 908, DATË 4.11.2024, “PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË”

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 908, datë 4.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së



murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Italisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

VENDIM
Nr. 67, datë 8.4.2025

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT PËR MUAJIN MARS 2025 PËR
KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E
TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.04.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1452/1 prot., datë 04.04.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin mars 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

I -Aspektet Ligjore dhe Procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga FSHU sh.a.

Shoqëria FSHU sh.a., me shkresën nr. 1645 prot., datë 01.04.2025, protokolluar në ERE me nr. 1452 prot., datë 02.04.2025, ka depozituar kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin mars 2025, për klientët e lidhur

në nivelin e tensionit 35 kV që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të ERE-s, në përputhje me nenin 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar.

II – Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i mundësisë së Fundit për muajin mars 2025, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin mars 2025, FSHU sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokurara, çmimet ditore/orare, dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlogaritja e Çmimit Mesatar të Ponderuar të Blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, FSHU ka përlogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë për muajin mars 2025, në vlerën **9.66 lekë/kWh**. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është **9.66 lekë/kWh**.

3. Komponentët sipas Metodologjisë (Neni 8, vendimi nr. 201, datë 04.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- **Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt)** për muajin mars 2025: **9.66 lekë/kWh**

- **Kthimi për riskun (3%): 0.29 lekë/kWh**

- **Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike** për periudhën 1 shkurt 2025 – 31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 279, datë 16.12.2024: **0.85 lekë/kWh**



- **Tarifa e shërbimit të shpërndarjes** në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE nr. 288, datë 23.12.2024, “Mbi lënie në fuqi të vendimit të bordit të ERE nr. 73, datë 13.04.2022”: **1.55 lekë/kWh**

- **Kostot administrative: 1.06 lekë/kWh**

- **Kurset zyrtare të këmbimit** të publikuara nga Banka e Shqipërisë (Lekë/Euro), për çdo datë respektive në harkun kohor **28.02.2025 – 28.03.2025**

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2025, përlogaritjet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin mars 2025			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	9.66
Pr	Kufiri për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.29
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr + CBEt + TRr + TSHt + CA		Lekë/kWh	13.41

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

• Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë **13.41 Lekë/kWh për muajin mars 2025**.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin mars 2025 prej 13.41 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategoritë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit

në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 68, datë 8.4.2025

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “RENEW” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET PRODHUES 2 mw

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1452/1prot., datë 4.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Renew’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Renew” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1159 prot., datë 18.2.2025, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier.



- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 52, datë 3.3.2025, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 4.3.2025 dhe 5.3.2025) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.3.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1159/4 prot., datë 6.3.2025, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore në ambientet e ERE-s, me qëllim sqarimin e informacionit/dokumentacionit të munguar të aplikimit.

- Gjithashtu, me shkresën nr. 1159/5 prot., datë 6.3.2025, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, si dhe për zhvillimin e një seance dëgjimore në ERE, me qëllim marrjen e sqarimit/qëndrimit përkatës të MIE-s, në lidhje me zbatimin e detyrimeve të shoqërisë për sa i përket afateve të ndërtimit/vënies në punë të centralit dhe/ose të vlefshmërisë së kontratës.

- Në seancën e zhvilluar në datën 13.3.2025, u paraqit vetëm përfaqësuesja e shoqërisë dhe nuk u paraqitën përfaqësues të MIE-s. Në vijim të sqarimeve të dhëna në seancë nga ana e përfaqësueses së shoqërisë, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1159/6 prot., datë 13.3.2025, është depozituar dokumentacion shtesë.

- ERE me *email*-in nr. 1159/7 prot., datë 26.3.2025, i ka kërkuar shoqërisë që të depozitojë në ERE njoftimin/korrespondencën përkatëse me MIE-n, në lidhje me mungesën e faqes 10 të kontratës së nënshkruar me të.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1159/8 prot., datë 26.3.2025, nga shoqëria është bërë me dije se pas kërkesës së bërë pranë MIE-s, në arkivin e saj është gjendur kontrata e plotë, ndaj një kopje e plotë e kontratës është depozituar në ERE.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se:

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

- Shoqëria ka nënshkruar me MIE-n, kontratën nr. 2426 rep., nr. 1571 kol, datë 28.4.2023, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier”, nënshkruar ndërmjet MIE-s dhe Mbajtësit të Miratimit për Ndërtim, shoqërisë “Renew” sh.p.k.

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së “OSSH” sh.a., nr. 5592/3 prot., datë 6.9.2024.

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më 17.7.2024, për ndërtimin e impiantit fotovoltaike me fuqi 2 mw.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- Kontrata e nënshkruar me MIE-n me nr. 2426 rep., nr. 1571 kol., datë 28.4.2023, parashikon një afat 49-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

- Bazuar në nenin 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, afati i vlefshmërisë së licencave për veprimtaritë e prodhimit, nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet.

- Bazuar në nenin 9, pikën 1.2, germën “c”, të rregullores së licencimit, shoqëria duhet të përditësojë në ERE informacionin mbi strukturën organizative të shoqërisë, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar. Shoqëria ka depozituar në ERE strukturën organizative, në të cilën aktualisht rezultojnë: Asambleja e Përgjithshme, e përbërë nga ortaku i vetëm dhe administratori. Bashkëpunëtori i vetëm i jashtëm i saj në këtë fazë është shoqëria “Kirac Green Energy” sh.p.k., me të cilën ka lidhur “Kontratë për ndërtimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike me kapacitet prodhues 2mw, Topojë, Fier”, datë 10.1.2024, të cilën e ka depozituar në ERE. Në nenin 3 të kësaj kontrate përcaktohet kontraktori (shoqëria “Kirac Green Energy” sh.p.k.) që do të kryejë të gjitha punimet, duke filluar nga projektimi, furnizimi i materialeve, ndërtimi, instalimi, testimi, kolaudimi vënia në punë, si dhe mirëmbajtja e pajisjeve. Gjithashtu, shoqëria ka sqaruar se pas pajisjes me licencë nga ERE, organigrama e saj do të jetë si



vijon: Administratori, Sekretaria, Financa, Departamenti Teknik, Departamenti Juridik.

Në referencë të përcaktimeve të këtij neni, vlerësohet që shoqërisë t'i lihet kusht për të përfitësuar informacionin mbi organigramën e saj me stafin teknik për kryerjen e veprimtarisë së licencimit.

- VNM-ja është e vlefshme deri më datë 17.7.2026, por duke qenë se shoqëria parashikon të vendosë në operim centralin brenda muajit shtator 2025, vlerësohet që t'i lihet kusht që të raportojë në ERE fillimin e punimeve brenda datës 31.8.2025. Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, të dokumentacionit të depozituar në ERE, në kuadër të këtij aplikimi, si dhe të parashikimit të bërë nga ana e saj, shoqëria parashikon të vendosë në operim centralin brenda datës 30.9.2025.

- Po ashtu, në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, me fillimin e operimit, por jo më vonë se 60 ditë nga ky moment, shoqëria duhet të dorëzojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të vendimit në rast se nga ana e MIE-s do të depozitohet ndonjë qëndrim i ndryshëm në lidhje me vlefshmërinë e kontratës.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Renew” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 2 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3358, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, qarku Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të raportojë në ERE, në lidhje me fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit, brenda datës 31.8.2025.

3. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.9.2025.

4. Me fillimin e operimit, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e fillimit të operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës, si dhe duhet të përfitësojë në ERE

informacionin mbi strukturën organizative të shoqërisë, e cila duhet të përmbajë stafin teknik sipas veprimtarisë së licencuar.

5. Ky vendim është objekt rishikimi në rast të përmbushjes apo mospërmbushjes së kushteve të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Renew” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 69, datë 8.4.2025

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “NAD INVESTMENT” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve të nenit 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 13, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2025,



mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1408/1 prot., datë 4.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘NAD Investment’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “NAD Investment” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1408 prot., datë 25.3.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave (“a”, “b” dhe “c”), duke plotësuar formularin sipas formatit të shtojcës 1. Ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, duke plotësuar të dhënat e subjektit, përfshirë emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe administratorin. Aplikuesi deklaron se angazhohet për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s dhe ka kryer pagesën e aplikimit më 18.3.2025, sipas aneksit A.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b”, “c” dhe “d”. Aplikuesi ka dorëzuar ekstraktin historik të regjistrit tregtar të vulosur elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), më datë 10.3.2025. Nga dokumenti rezulton se shoqëria “NAD Investment” sh.p.k. është regjistruar më datë 18.3.2024, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Gjithashtu, aplikuesi ka dorëzuar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore të vulosura elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me nr. kerkese 11, datë 10.3.2025, nga të cilat rezulton se si administratori i shoqërisë dhe vetë shoqëria, janë të padënuar. Po ashtu aplikuesi ka paraqitur strukturën organizative të shoqërisë e cila është përshtatur për të mbështetur ushtrimin e veprimtarive të tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike, për të cilat është paraqitur aplikim në ERE. **Germa “d”** – nuk aplikohet në këtë rast, pasi

aplikuesi nuk ka caktuar një përfaqësues ligjor dhe për rrjedhojë nuk ka depozituar akt përfaqësimi.

- Në përputhje me pikën 1.3, të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar në ERE dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a”, “b” dhe “c”. Sipas germës “a”, janë paraqitur vërtetimet e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, datë 10.3.2025, të cilat konfirmojnë se shoqëria nuk ka detyrime të papaguara ndaj administratës tatimore dhe institucioneve të sigurimeve. Për shkak të regjistrimit të shoqërisë më 18.3.2024 dhe afatit ligjor për dorëzimin e pasqyrave financiare (31.3.2025), këto nuk janë ende të disponueshme. Në vend të tyre, aplikuesi ka paraqitur projeksione mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë në pesë vitet në vijim, me 6 gwh për vitin e parë, ose 500 mwh në muaj. Mbështetja financiare për një muaj veprimtari është përlllogaritur bazuar në çmimin e ALPEX-it për muajin shkurt 2025, dhe për këtë qëllim është dorëzuar një letër interesi nga **Credins Bank sh.a.**, datë 7.3.2025, që shpreh gatishmërinë për të mbështetur financiarisht shoqërinë në këtë veprimtari. Gjithashtu, aplikuesi ka paraqitur Planin e Biznesit për periudhën 2025–2030, i cili përfshin analizën e tregut për vitet 2021–2024 dhe parashikime për kostot, të ardhurat, shitjet dhe burimet e financimit për pesë vitet e ardhshme.

- Në përputhje me pikën 2.5 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqëria ka paraqitur në ERE parashikimin e sasisë së energjisë elektrike që synon të tregtojë gjatë pesë viteve të vlefshmërisë së licencës.

- Shoqëria rezulton ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit, në përputhje me përcaktimet e aneksit A të rregullores.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “NAD Investment” sh.p.k. dhe për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data



e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 70, datë 8.4.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “NAD INVESTMENT”
SHPK PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordin i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1409/1 prot., datë 4.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “NAD Investment” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1409 prot., datë 25.3.2025, ka paraqitur kërkesën për pajisje me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe në përputhje me përcaktimet e “Rregullores për procedurat dhe afatet

për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisje me licencë, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në germat (a), (b) dhe (c), duke plotësuar formularin sipas formatit të shtojcës 1. Shoqëria ka paraqitur kërkesën për pajisje me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, duke deklaruar të dhënat e subjektit, përfshirë: emrin, NUIS-in, adresën, kontaktet dhe emrin e administratorit. Aplikuesi ka deklaruar angazhimin për zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullave të ERE-s, si dhe ka kryer pagesën për aplikimin më datë 18.3.2025, në përputhje me përcaktimet e aneksit A të rregullores.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar, sipas germave (a), (b), (c) dhe (d). Aplikuesi ka dorëzuar ekstraktin historik të regjistrit tregtar, të vulosur elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), më datë 10.3.2025. Nga ky dokument rezulton se shoqëria “NAD Investment” sh.p.k. është regjistruar më datë 18.3.2024 si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.). Megjithatë, në objektin e veprimtarisë së saj nuk përfshihet furnizimi me energji elektrike, ndaj vlerësohet se aplikuesit duhet t’i kërkohej të bëjë plotësimet përkatëse dhe të depozitojë një ekstrakt të përditësuar. Gjithashtu, aplikuesi ka dorëzuar në ERE vërtetimet e gjendjes gjyqësore, të vulosura elektronikisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me nr. kerkese 11, datë 10.3.2025, nga të cilat rezulton se si administratori i shoqërisë, ashtu edhe vetë shoqëria, janë të padënuar. Po ashtu, aplikuesi ka paraqitur strukturën organizative të shoqërisë, e cila është përshtatur për të mbështetur ushtrimin e veprimtarive të tregtimit dhe furnizimit me energji elektrike, për të cilat është paraqitur aplikim pranë ERE-s. Germa “d” – Nuk aplikohet në këtë rast, pasi aplikuesi nuk ka caktuar një përfaqësues ligjor dhe, për rrjedhojë, nuk ka depozituar akt përfaqësimi.



- Në përputhje me pikën 1.3 të Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar në ERE dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar, sipas germës “a”. Në zbatim të kësaj pike, janë paraqitur dy vërtetime, të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, datë 10.3.2025, nga të cilat rezulton se shoqëria “NAD Investment” sh.p.k. nuk ka detyrime të papaguara tatimore, si dhe nuk ka detyrime të prapambetura në lidhje me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

- Shoqëria **rezulton se ka kryer pagesën e tarifës së aplikimit**, në përputhje me përcaktimet e aneksit A të Rregullores.

- Në këtë aplikim duhet të plotësohet dhe sa vijon:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

Germa “b”:

- Në dosjen e aplikimit, shoqëria ka paraqitur informacion në lidhje me sasinë e energjisë elektrike që parashikon të tregtojë, duke qenë se ka aplikuar paralelisht edhe për tregtimin e energjisë elektrike, por nuk ka dhënë informacion, në lidhje me sasinë e energjisë elektrike që parashikon të furnizojë, në mënyrë që të bëhet përlllogaritja përkatëse për mbështetjen financiare që i nevojitet për të garantuar ushtrimin e të paktën 1 muaji të aktivitetit.

- Po ashtu, në kuadër të mbështetjes financiare, shoqëria ka depozituar në ERE **Letrën e Interesit të Credins Bank sh.a.**, me nr. 19583 prot., datë 7.3.2025, në të cilën banka shprehet se është e gatshme të mbështesë shoqërinë për financim, në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike, por nuk i referohet aktivitetit të furnizimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, shoqëria duhet të depozitojë informacionin mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të furnizojë, si dhe dokumentacionin që vërteton mbështetjen financiare të nevojshme për të garantuar të paktën 1 muaj të kësaj veprimtarie.

- Germa “c”:

- Shoqëria ka depozituar në ERE Planin e biznesit mbi aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike në Shqipëri për periudhën 2025–2030, por duke qenë se shoqëria po aplikon për pajisje me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë, do

t’i kërkohej që të depozitojë Planin e Biznesit të dedikuar për këtë veprimtari.

Për gjithë sa më sipër, shoqëria duhet të depozitojë Planin e Biznesit të dedikuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Pika 2.4. Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

- Germa “a”:

Shoqëria ka paraqitur informacion që i referohet veprimtarisë së tregimit të energjisë elektrike dhe jo asaj të furnizimit, ndaj **duhet të paraqesë informacion mbi sasinë e energjisë elektrike që parashikon të furnizojë në 5 vjetët e ardhshëm të licencës.**

- Germa “b”:

Shoqëria deklaron se ka parashikuar që, pas pajisjes me licencat përkatëse, në lidhje me sistemin IT, do të instalojë një sistem me të cilin punon në Damas, për të hedhur të dhënat, nominimet dhe skedulimet në sistemin e OST-së. Për sa më sipër rezulton se nuk është bërë me dije sistemi që do të përdoret nga shoqëria, në lidhje me realizimin e procesit të faturimit të klientëve pasi informacioni i dorëzuar në ERE adreson sistemin IT për marrëdhëniet e shoqërisë me operatorin e rrjetit dhe jo me klientët.

Për sa më sipër, shoqëria duhet të bëjë me dije mbi sistemin IT që do të përdorë në lidhje me realizimin e procesit të faturimit të klientëve.

- Germa “c”:

Shoqëria ka depozituar Kontratën e Huapërdorjes (për pasuri të paluajtshme të nënshkruar ndërmjet shoqërisë “Lura” sh.p.k., si **Huadhënësi**, dhe shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k., si **Huamarrësi**. Objekti i kontratës është **huapërdorja e pronës**, ndërsa qëllimi i përdorimit të saj është vetëm për ushtrimin e aktivitetit të **Huamarrësit**. Në nenin 3 të kësaj kontrate përcaktohet se **data e fillimit të huapërdorjes është 13.2.2025** dhe se **kohëzgjatja fillestare është 1-vjeçare**. Po në këtë nen parashikohet se kontrata është **e rinovueshme automatikisht**, me të njëjtat kushte dhe terma, për periudha pasuese njëvjeçare, **përveçse në rastet kur ndonjëra nga palët kërkon zgjidhjen ose mosrinovimin e saj.**

Për sa më sipër, duke qenë se licenca për furnizimin e energjisë elektrike jepet për një afat 5-vjeçar, ndërsa kontrata e paraqitur nga shoqëria ka një kohëzgjatje 1-vjeçare, duke përfshirë edhe



mundësinë që ajo të mos rinovohet pas përfundimit të kësaj periudhe, ***shoqëria duhet të paraqesë informacion në lidhje me disponueshmërinë e ambienteve të zyrave për 4 (katër) vjetët e mbetur të afatit të licencës. Në të kundërt, vendimi i mundshëm për licencimin e veprimtarisë do të jetë me kusht, që shoqëria, në përfundim të afatit të kontratës së huapërdorjes së pronës, të depozitojë pranë ERE-s kontratën e rinovuar.***

- Germa “d”:

Shoqëria duhet të depozitojë informacion mbi nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes së energjisë elektrike për klientët.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “NAD Investment” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të Bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 71, datë 8.4.2025

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “GEGA-G” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1,

germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 13, si dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 189/17 prot., datë 1.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Gega-G’ sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

I. Aspektet procedurale të rinovimit të licencës

1. Fillimi i procedurës së rinovimit

- Me vendimin nr. 23, datë 20.1.2025, Bordi i ERE-s vendosi të nisë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Gega-G” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (licencë e dhënë më parë me vendimin nr. 64, datë 8.4.2020).

- Njoftimi për fillimin e procedurës u publikua në median e shkruar (21–22 janar 2025) dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Deri më datë 30.1.2025, nuk janë paraqitur komente, apo objeksione nga palë të treta.

2. Komunikimi me aplikantin

- Me shkresën nr. 189/2 prot., datë 22.1.2025, ERE kërkoj nga shoqëria sqarime lidhur me ndryshimet në dokumentacion.

- Shoqëria ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 189/3 prot., datë 4.2.2025, duke depozituar dokumentacion shtesë, por **pa dhënë sqarime lidhur me dokumentet që i referohen veprimtarisë.**

3. Zgjatje e afatit të vendimmarrjes

- Me vendimin nr. 38, datë 10.2.2025, bordi zgjati afatin e vendimmarrjes me 30 ditë, për shkak të nevojës për depozitimin nga shoqëria të shpjegimeve plotësuese të kërkuara nga ERE, lidhur me ndryshimet në dokumentacion.

4. Seanca dëgjimore dhe dokumentacioni vijues

- Shoqëria u njoftua për zhvillimin e një seance dëgjimore me shkresën nr. 189/6 prot., datë 17.2.2025.



Kjo seancë u mbajt më datë 24.2.2025 dhe në vijim, u depozitua dokumentacion plotësues (shkresa nr. 189/7 prot., datë 3.3.2025), por u konstatua mungesa e **Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore** për shoqërinë. Ky dokument u depozitua më pas me shkresën nr. 189/12 prot., datë 7.3.2025.

5. Aspekte të tjera dhe zgjatja e dytë e afatit të vendimarrjes

- Me vendimin nr. 59, datë 10.3.2025, bordi vendosi të zgjasë afatin e vendimarrjes me 20 ditë, periudhë gjatë së cilës subjekti duhej të depozitonte deklaratën mbi shumën e dedikuar për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, të kërkuar nga ERE.

- Pas disa komunikimeve, deklaratata u depozitua në format origjinal me nr. 189/16 prot., datë 20.3.2025.

II. Përputhshmëria me rregullat dhe dokumentacioni i depozituar

Në përputhje me Rregulloren e sipërcituar për licencimin (vendimi nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar), shoqëria ka përmbushur detyrimet e mëposhtme:

Neni 16 i Rregullores – Rinovimi i licencës

- Germa “a”: Format i aplikimit i plotësuar (shtojca 1) – Plotësuar;

- Germa “b”: Të dhëna identifikuese të aplikuesit – Plotësuar;

- Germa “c”: Deklaratat e aplikuesit – Plotësuar;

- Germa “d”: Ndryshime/modifikime në dokumentacion – Plotësuar;

- Germa “e”: Informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë së licencuar – Shoqëria nuk ka përcjellë informacion në lidhje me sa kërkohet në këtë pikë të Rregullores. Megjithatë, referuar të dhënave të tregut të energjisë elektrike të disponuara nga ERE, të publikuara, gjithashtu, në faqen zyrtare të saj, si dhe duke iu referuar pagesave rregullatore – ku përgjatë gjithë periudhës së licencës shoqërisë i është caktuar një pagesë fikse – dhe pasqyrave financiare të analizuara, rezulton se shoqëria nuk e ka ushtruar më parë veprimtarinë e licencuar.

III. Aspektet e pajisjes me leje dhe miratime

1. Licenca dhe përputhshmëria

- Shoqëria ka qenë e pajisur me licencë për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike që nga data 8.4.2020. Gjatë periudhës së vlefshmërisë së licencës, nuk janë konstatuar shkelje të kushteve të saj që të justifikojnë revokimin apo mosrinovimin e saj.

2. Dokumentacioni mbështetës i depozituar për pajisjen me licencë

- Vërtetimet e gjendjes tatimore dhe gjyqësore – rezulton pa detyrime tatimore dhe i padënuar penalisht.

- Pasqyrat financiare – rezulton me fitim për tre vjetët e fundit, por jo nga veprimtaria e tregimit të energjisë elektrike.

- Dokumentacion mbi strukturën organizative dhe burimet njerëzore – i depozituar në përputhje me kërkesat e rregullores.

- Vërtetimet e gjendjes bankare dhe deklaratata mbi shumën e dedikuar për tregtim – të dorëzuara brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

- Deklarimi i parashikimeve për energjinë dhe përllogaritja për mbështetje financiare njëmuajore – i dorëzuar në përputhje me kërkesat e rregullores përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “Gega-G” sh.p.k., për veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, e dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 64, datë 8.4.2020, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 9.4.2025.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Gega-G” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti



VENDIM
Nr. 72, datë 8.4.2025

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË
BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “5GX ENERGY” SHPK PËR
MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE
PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET
VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE)
TË ASETEVE FIKSE TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 35/13 prot., datë 1.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX Energy” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve fikse të saj”,

konstatoi se:

- Për qëllime të shqyrtimit të këtij aplikimi janë ndjekur procedurat dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Paraqitja e kërkesës për licencim

- Shoqëria “5GX Energy” sh.a., më datë 8.1.2025 dorëzoi kërkesën për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) e aseteve fikse të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Tirana Bank” sh.a.

2. Fillimi i procedurës për transferimin e aseteve

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 26, datë 27.1.2025, vendosi të fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

- ERE ka njoftuar shoqërinë dhe MIE-n, në lidhje me këtë vendim nëpërmjet shkresës nr. 35/5 prot., datë 6.2.2025.

3. Vlerësimi i dokumentacionit dhe kërkesa për seancë dëgjimore

- Me shkresat nr. 35/3 prot., dhe nr. 35/4 prot., datë 3.2.2025, ERE njoftoi shoqërinë dhe Tirana

Bank sh.a. për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 13.2.2025, duke i kërkuar shoqërisë plotësimin e dokumentacionit të munguar, përfshirë: gjendjen financiare në momentin e paraqitjes së kërkesës, marrëveshjen paraprake me listën e aseteve, çdo transferim të mëparshëm, si dhe qëndrimin lidhur me faktin që marrëveshja është nënshkruar pa marrë më parë autorizimin e ERE-s.

- Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresën nr. 35/6 prot., datë 18.2.2025, ERE kërkoi depozitimin e angazhimeve të deklaruara gjatë saj. Gjatë seancës, përfaqësuesit e bankës dhe të shoqërisë deklaruan se do të anulonin marrëveshjen ekzistuese të barrës siguroese mbi asetet e shoqërisë, do të kryenin fshirjen e saj nga Regjistri i Barrës Siguroese dhe do të paraqisnin pranë ERE-s një marrëveshje të re, e cila do t'i nënshtrohej më parë miratimit të institucionit.

4. Dorëzimi dhe vlerësimi i dokumentacionit plotësues

- Pas seancës dëgjimore të datës 13.2.2025, në mungesë të dokumentacionit përkatës, ERE, me shkresën nr. 35/6 prot., datë 18.2.2025, u kërkoi shoqërisë dhe bankës depozitimin e angazhimeve të deklaruara. Më pas, me shkresën nr. 35/7 prot., datë 19.2.2025, shoqëria kërkoi pezullimin e shqyrtimit deri në plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

- Me e-mail-in e datës 24.2.2025, ERE kërkoi dorëzimin e dokumentacionit të munguar që varej vetëm nga shoqëria, si dhe një afat të arsyeshëm për përmbushjen e tij. Si përgjigje, me shkresën nr. 35/8 prot., datë 27.2.2025, shoqëria plotësoi pjesërisht dokumentacionin dhe kërkoi pezullimin e procedurës deri më 17.3.2025.

- Në datën 17.3.2025, Tirana Bank sh.a., me shkresën nr. 35/9 prot., shoqëria dorëzoi marrëveshjen e re siguroese nr. 534 rep., nr. 384 kol., datë 12.3.2025 dhe vërtetimin e fshirjes nga RBS të marrëveshjes së mëparshme nr. 2691 rep., nr. 1731 kol., datë 10.12.2024. Në të njëjtën datë, edhe shoqëria, me shkresën nr. 35/10 prot., përcolli të njëjtin dokumentacion.

- Me shkresën nr. 35/11 prot., datë 18.3.2025, ERE kërkoi sqarim nëse data 17.3.2025 përfaqësonte dorëzimin final të dokumentacionit apo datën e pritshme të formalizimit. Në vijim, me shkresën nr. 35/12 prot., datë 20.3.2025, shoqëria depozitoi marrëveshjen e re siguroese nr. 533 rep., nr. 383 kol., datë 12.3.2025, për vendosjen e barrës



së radhës së parë në favor të Tirana Bank sh.a., e bashkëlidhur këtij relacioni.

5. Shtyrja e afatit të vendimarrjes

- Referuar nenit 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i ERE-s vlerëson zgjatjen me 30 ditë të vendimarrjes, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “5GX Energy” sh.a. për transferimin e aseteve fikse të saj nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimarrjes së Bordit të ERE mbi kërkesën e shoqërisë “5GX Energy” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve fikse të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Tirana Bank” sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “5GX Energy” sh.p.k. vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 75, datë 14.4.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe

të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 723/2 prot., datë 20.3.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Yldirim Energy Europe Albania’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj të tretëve”,

Konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 127/11 prot., datë 10.6.2024, paraqiti aplikimin për marrjen e autorizimit për vendosjen e barrës siguroese mbi 100% të kuotave të saj, të zotëruara nga “Yldirim Albania Mining Investments” sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga “Marrëveshja e huas së nivelit të lartë”, datë 24.5.2022, e lidhur ndërmjet “Yldirim International Mining Investments B.V.”, “Albchrome” sh.p.k. dhe “Yldirim Albania Mining Investments” sh.p.k., si kredimarrës, dhe disa institucioneve financiare ndërkombëtare, me “Raiffeisen Bank” sh.a. në rolin e agentit të garancive. Në zbatim të kushteve të kësaj marrëveshjeje është nënshkruar, gjithashtu, “Marrëveshja e barrës siguroese kuota/aksione” nr. 2169 rep., nr. 1123 kol., datë 21.6.2022, ndërmjet “Raiffeisen Bank” sh.a., në cilësinë e barrëmarrësit, dhe “Yldirim Albania Mining Investments” sh.p.k., në cilësinë e barrëdhënësit, mbi 100% të kuotave të shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Shoqëria “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. është licencuar nga ERE, në:

- Veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 257, datë 21.12.2021; si dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021.

- Në mbledhjen e Bordit, datë 19.7.2024, u vlerësua se, përpara se ERE të shprehej me një vendimarrje për dhënie e autorizimit, shoqëria



duhej të dokumentonte shlyerjen e kësteve të huas dhe të depozitonte qëndrimin përkatës të bankës, në kushtet kur marrëveshja e paraqitur për miratim nuk ishte një marrëveshje paraprake por një marrëveshje e lidhur nga palët, e cila kishte prodhuar efektet e saj përmes lidhjes së mëposhme të “Marrëveshjes së barrës siguruese kuota/aksione” nr. 2169 rep., nr. 1123 kol., datë 21.6.2022. Kjo kërkesë u bë në funksion të plotësimit të kuadrit të provave mbi përputhshmërinë e garancisë me rregulloren përkatëse, si dhe për shkak se deklarimi për kthimin e kuotave në gjendjen e mëparshme ishte depozituar vetëm nga shoqëria, ndërkohë që mungonte qëndrimi i bankës si palë tjetër në marrëveshje.

- Me shkresën nr. 127/16 prot., datë 6.9.2024, ERE njoftoi shoqërinë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

3. Seanca dëgjimore dhe dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Më datë 18.11.2024, u zhvillua seanca dëgjimore me përfaqësuesit e ERE-s, shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. dhe “Raiffeisen Bank” sh.a.

- “Raiffeisen Bank” sh.a. përcolli qëndrimin e saj me shkresën nr. 127/21 prot., datë 26.12.2024.

- Shoqëria paraqiti informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar me shkresën nr. 723 prot., datë 29.4.2025.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë, në përputhje me kërkesat e rregullores;

Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike;

- Neni 5, pika 5 – Shoqëria ka bërë me dije se marrëveshja e kredisë nuk duhet të jetë e hapur për publikun, pasi klasifikohet si informacion konfidencial.

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 8:

- Pika 1 – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet për vendosjen e barrës siguruese, përshkrimi i detyrimeve dhe deklarata mbi statusin e kuotave;

- Pika 2 – Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror, si më poshtë vijon:

- Germa “a” – Ekstrakti historik i regjistrit tregtar: shoqëria ka depozituar në ERE ekstraktin e thjeshtë të regjistrit tregtar, të vulosur elektronikisht më datë 6.6.2024. Nga aksesimi *online* i ekstraktit historik rezulton se shoqëria “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. është regjistruar në QKB më 7.9.2021. Ortak i vetëm është “Yldirim Albania Mining Investment” sh.p.k. Shoqëria nuk ka pasur më parë raste të vendosjes së barrës siguruese mbi kuota;

- Germa “b” – Vendimi i organeve drejtuese: është depozituar vendimi i Ortakut të Vetëm, i datës 27.4.2022 (në gjuhën shqipe dhe angleze), që miraton vendosjen e barrës siguruese mbi kuotat;

- Germa “c” – Marrëveshjet përkatëse: janë depozituar:

- Marrëveshja e huas së nivelit të lartë, datë 24.5.2022, ndërmjet kredimarrësve dhe kredidhënësve, ku përcaktohet vendosja e barrës mbi kuotat e “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k.;

- Marrëveshja e barrës siguruese nr. 2169 rep., nr. 1123 kol., datë 21.6.2022, ndërmjet “Raiffeisen Bank” sh.a. (agent i garancive) dhe “Yldirim Albania Mining Investments” sh.p.k. (barrëdhënës), që vendos barrën siguruese mbi 100% të kuotave të shoqërisë.

Duke qenë se këto marrëveshje janë lidhur përpara marrjes së autorizimit të ERE-s, shoqëria ka depozituar me shkresën nr. 127/7 prot., datë 27.3.2024, deklaratën e Ortakut të Vetëm “Yldirim Albania Mining Investments” sh.p.k., ku konfirmohet angazhimi për heqjen e barrës siguruese dhe kthimin e strukturës së kuotave në



gjendjen e mëparshme në rast të mosmarrjes së autorizimit. Në vijim, është depozituar, gjithashtu, edhe qëndrimi zyrtar i “Raiffeisen Bank” sh.a., me shkresën nr. 127/21 prot., datë 26.12.2024, ku banka shpreh gatishmërinë për të rishikuar parashikimet e marrëveshjeve të nënshkruara nëse nuk do të merrej autorizimi nga ERE, duke përmbushur kështu të gjitha kërkesat përkatëse në lidhje me këtë çështje.

- **Pika 3** – Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve, nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga kuadri ligjor ose nga marrëveshjet kontraktuale në fuqi.

Vendosja e këtij kushti bëhet për të garantuar se autorizimi i dhënë nga ERE mbetet i kufizuar vetëm në kuadër të ushtrimit të funksioneve të saj rregullatore, pa ndërhyrë apo anashkaluar detyrimet ligjore ose kontraktuale që mund të ketë shoqëria ndaj autoriteteve të tjera ose palëve të përfshira në marrëdhënie financiare apo tregtare. Në këtë rast, duke qenë se marrëveshja e huas dhe marrëveshja siguruese janë nënshkruar me banka të huaja dhe vendase, është përgjegjësi e shoqërisë të respektojë çdo detyrim tjetër jashtë kompetencës së ERE-s që mund të rrjedhë nga këto marrëveshje.

- Shoqëria detyrohet të njoftojë ERE-n në rast të heqjes së barrës siguruese ose të ekzekutimit të saj të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k., si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit sipas “Marrëveshjes së huas së nivelit të lartë”, datë 24.5.2022, dhe në vijimësi të së cilës është nënshkruar “Marrëveshja e barrës siguruese kuota/aksione” me nr. 2169 rep., nr. 1123 kol., datë 21.6.2022, ndërmjet “Raiffeisen Bank” sh.a., në cilësinë e barrëmarrësit, dhe shoqërisë “Yildirim Albania Mining Investments” sh.p.k., në cilësinë e barrëdhënësit.

2. Dhënia e Autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 76, datë 14.4.2025

MBI PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 222, DATË 23.10.2024, LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË “HYDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN (NËPËRMJET HIPOTEKIMIT) TË ASETEVE FIKSE TË SAJ

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 64, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i



Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 259/4 prot., datë 1.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hydropowerplant Construction’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “Hydropowerplant Construction” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2039 prot., datë 4.10.2024, paraqiti kërkesën për marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme, në funksion të garantimit të përmbushjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Banka Amerikane e Investimeve” sh.a.

2. Fillimi i procedurës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 222, datë 23.10.2024, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kësaj kërkesë.

- Me shkresën nr. 2039/4 prot., datë 4.11.2024, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin e mësipërm dhe për mangësitë në dokumentacionin e depozituar.

- MIE u informua për këtë procedurë me shkresën nr. 2039/3 prot., datë 28.10.2024.

3. Kërkesa për pezullim

- Shoqëria, me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 2039/6 prot., datë 24.12.2024, paraqiti kërkesën për pezullimin e procedurës, duke argumentuar se ka pasur një vonesë të tejzgjatur nga banka për plotësimin e dokumentacionit.

- Me shkresën nr. 259 prot., datë 23.1.2025, ERE i kërkoi shoqërisë të bënte me dije mbi afatin, në lidhje me kërkesën për pezullimin e procedurës.

- Shoqëria, me shkresën nr. 259/1 prot., datë 12.2.2025, informoi se, si pasojë e mungesës së dakordësisë me bankën për vijimin e procesit të financimit, marrëveshja për kredi ishte ndërprerë.

- Në vijim të shkresës së ERE nr. 259/2 prot., datë 4.3.2025, shoqëria, me shkresën nr. 259/3 prot., datë 17.3.2025, informoi se heq dorë nga aplikimi për marrjen e autorizimit për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme dhe se, në rast të nënshkrimit të një marrëveshjeje të re me një bankë të nivelit të dytë, do të paraqesë një aplikim të ri.

4. Vlerësimi ligjor për përfundimin e procedurës

- Në përputhje me nenin 64, pika 2, të ligjit nr. 45/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, një palë ka të drejtë të tërhiqet nga procedura administrative përmes një kërkesë me shkrim, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes, organi publik vendos përfundimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 222, datë 23.10.2024, “Mbi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë ‘Hydropowerplant Construction’ sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve fikse të saj”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Hydropowerplant Construction” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 77, datë 14.4.2025****MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA
ERE PËR VENDOSJEN E
TRANSFERIMIT NËPËRMJET
VENDOSJES SË BARRËS SIGURUESE
TË ASETEVE FIKSE TË SHOQËRISË
“M.C. ENERGJI GOJAN” SHA**

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, germa “b”, 6, 7 dhe 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 169/10 prot., datë 20.3.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘M.C. Energji Gojan’ sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve fikse të saj”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. është e licencuar nga ERE në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Gojan”, me kapacitet të instaluar 15 mw, me vendndodhje në lumin Fan i Madh, në zonën midis fshatrave Shkozë dhe Gojan, Njësia Administrative Gjegjan, Bashkia Pukë, qarku Shkodër, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 169 prot., datë 16.1.2025, shoqëria paraqiti kërkesën për marrjen e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme të saj si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a.

2. Procedura e ndjekur

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 32, datë 3.2.2025, vendosi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë.

- Për vendimmarrjen në fjalë, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 35/5 prot., datë 6.2.2025, si dhe me shkresën nr. 169/3 prot., datë 12.2.2025, ERE njoftoi shoqërinë për vendimin e Bordit, si dhe kërkoj plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për vijimin e procedurës.

- Në përgjigje të shkresave të ERE-s nr. 169/3 prot., datë 13.2.2025 dhe nr. 169/7 prot., datë 25.2.2025, shoqëria, me shkresat nr. 169/6 prot., datë 20.2.2025, nr. 169/8 prot., datë 6.3.2025 dhe nr. 169/12 prot., datë 28.3.2025, ka depozituar dokumentacionin plotësues të kërkuar, përfshirë listën e aseteve të HEC-it, në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga ERE në shkresën nr. 169/9 prot., datë 13.3.2025.

3. Konstatime mbi përputhshmërinë me rregulloren

- Nga shqyrtimi përfundimtar i aplikimit, rezulton se shoqëria ka plotësuar dokumentacionin sipas kërkesave të nenit 7, pika 1, germat “a” deri “j”, si dhe të pikave 3, 4 dhe 6 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016.

4. Kushtet për dhënie e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar nuk e përjashton shoqërinë nga detyrimi për të siguruar miratimet përkatëse nga autoritetet e tjera publike apo palët e treta, nëse kjo kërkohet nga legjislacioni apo marrëveshjet kontraktuale në fuqi. Ky kusht vendoset për të garantuar që autorizimi i ERE-s të mos interpretohet si zëvendësim i detyrimeve të tjera ligjore, veçanërisht në rastet kur kontratat koncesionare parashikojnë miratime shtesë për vendosjen e barrës ose transferimin e aseteve.

- Për shkak të natyrës së barrës siguroese mbi asetet e licencuara, vlerësohet që shoqëria të detyrohet të njoftojë menjëherë ERE-n në rast të heqjes së kësaj barre apo të ndonjë ekzekutimi të detyrueshëm mbi këto asete.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “M.C. Energji Gojan” sh.a. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të saj, si mjet



për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj “Banka OTP Albania” sh.a., në bazë të “Marrëveshjes Siguruese” nr. 1269 rep., nr. 264 kol., datë 28.3.2025, të lidhur ndërmjet shoqërisë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k., në cilësinë e barrëdhënësit, dhe “Banka OTP Albania” sh.a., në cilësinë e barrëmarrësit (lista e aseteve bashkëlidhur).

2. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 1 nuk e çliron shoqërinë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. të njoftojë menjëherë ERE-n për heqjen e barrës siguruese mbi asetet e paluajtshme të saj që i shërbejnë veprimtarisë së licencuar ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se shoqëria dokumenton heqjen e hipotekës dhe barrës siguruese të radhës së parë të vendosur mbi asetet e saj.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Lista e aseteve të shoqërisë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k.

1. Vepra e marrjes, me vlerë 93,048,096 lekë.
2. Kanali i furnizimit, me vlerë 8,089,988 lekë.
3. Dekantuesi, me vlerë 95,743,738 lekë.
4. Tuneli i sjelljes, me vlerë 846,034,107 lekë.
5. Baseni i presionit, me vlerë 161,744,192 lekë.

6. Tubacioni, me vlerë 152,418,315 lekë.

7. Nënstacioni, me vlerë 7,845,692 lekë.

8. Godinë e centralit, me vlerë 91,372,816 lekë.

9. Kanali i shkarkimit, me vlerë 12,513,281 lekë.

10. Makineri e pajisje, me vlerë 722,683,914 lekë.

Në total rezultojnë 2,191,494,140 lekë.

VENDIM Nr. 78, datë 14.4.2025

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “M.C. ENERGJI GOJAN” SHPK SI MJET PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ TË TRETËVE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 9, pika 8, dhe 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 169/13 prot., datë 11.4.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘M.C. Energji Gojan’ sh.p.k. për dhënie e autorizimit nga Enti Rregullator i Energjisë për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënie e autorizimit për shoqërinë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. është e licencuar nga ERE në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Gojan”, me kapacitet të instaluar 15 mw, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 276, datë 13.12.2024.



- Me shkresën nr. 169 prot., datë 16.1.2025, shoqëria paraqiti aplikimin për marrjen e autorizimit për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj palës kredidhënëse “Banka OTP Albania” sh.a.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Gjatë shqyrtimit të kërkesës, ERE, me shkresat nr. 169/1 prot., datë 30. 1.2025, nr. 169/4 prot., datë 18.2.2025 (*email* rikujtesë), dhe nr. 169/7 prot., datë 25.2.2025, ka vënë në dukje mungesën e dokumentacionit të nevojshëm dhe ka kërkuar plotësimin e tij nga shoqëria.

- Në vijim, shoqëria ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar me shkresat nr. 169/5 prot. dhe nr. 169/6 prot., datë 20.2.2025, si dhe nr. 169/8 prot., datë 6.3.2025.

- Nga verifikimi rezulton se shoqëria “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. nuk ka detyrime të prapambetura financiare ndaj ERE-s.

3. Vlerësime dhe kushtet për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve nuk e përjashton shoqërinë nga detyrimi për të marrë autorizime/miratime nga organet apo institucionet e tjera përkatëse, në rast se kjo kërkohet prej tyre.

- Në referencë të nenit 9, pika 8, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 235, datë 26.11.2022, shoqëria është e detyruar të dorëzojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i reflektimit në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.

- Duke pasur parasysh natyrën e vendosjes së barrës siguroese mbi kuotat, e cila ndikon drejtpërdrejt në kontrollin e interesave të subjektit të licencuar, vlerësohet e nevojshme që shoqëria të detyrohet të njoftojë menjëherë ERE-n në rast të heqjes së kësaj barre ose në rast të një ekzekutimi të detyrueshëm.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit për vendosjen e kuotave të shoqërisë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga “Kontrata e kredisë” nr. 5045 rep., nr. 1262 kol.,

datë 20.12.2024, e lidhur ndërmjet “Banka OTP Albania” sh.a., në cilësinë e kredidhënësit, dhe shoqërisë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k., në cilësinë e kredimarrësit.

2. Dhënia e autorizimit nga ERE, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, nuk e çliron shoqërinë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet përkatëse nga organet ose institucionet e tjera, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Shoqëria “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga reflektimi në të i vendosjes së kolateralit mbi kuotat e saj.

4. Shoqëria duhet të njoftojë ERE-n për heqjen e barrës siguroese mbi kuotat ose në rast të ndodhjes së një ekzekutimi të detyrueshëm.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

6. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “M.C. Energji Gojan” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**

VENDIM

Nr. 79, datë 14.4.2025

MBI MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE NË “RREGULLOREN PËR SIGURINË KIBERNETIKE TË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 18, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë



kibernetike”; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturës së informacionit kritik dhe të rëndësishëm”, të ndryshuar me VKM-në nr. 761, datë 12.12.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 553, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave”; të “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 126, datë 30.7.2020; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 307/2 prot., datë 18.3.2025, të Drejtorisë Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve dhe Përgjegjësit të Sektorit të Sigurisë Kibernetike dhe IT-së “Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit dhe miratimit të disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë elektrike”, është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni, si më poshtë vijon:

1. Rregullorja në fuqi dhe nevoja për rishikim

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 126, datë 30.7.2020, ka miratuar “Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë elektrike”.

- Në vijim të hyrjes në fuqi të ligjit nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”, që ka shfuqizuar ligjin nr. 2/2017, si dhe pas ndryshimit të VKM-së nr. 553/2020 me VKM-në nr. 761, datë 12.12.2022, u puna me qëllim përditësimin e rregullave në fuqi me ndryshimet dhe shtesa në rregulloren ekzistuese për ta përafuar me kuadrin e ri ligjor në fuqi.

2. Fillimi i procedurës dhe njoftimi i palëve të interesuara

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 27.1.2025, vendosi fillimin e procedurës për ndryshimin e rregullores në fuqi.

- Me shkresën nr. 307 prot., datë 4.2.2025, ERE njoftoi për vendimin e mësipërm palët e interesit, si vijon: Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin Kombëtar për Sigurinë

Kibernetike (AKSK), OSHEE GROUP sh.a., Autoritetin e Konkurrencës (AK), Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Kurum International sh.a., Devoll Hydropower sh.a., Dragobia Energy sh.a., Prell Energy sh.p.k., Power Elektrik Slabinjë sh.p.k., Seka Hydropower sh.p.k. dhe Trans Adriatic Pipeline Ag Albania.

- Teksti i ndryshimeve dhe shtesave të propozuara u publikua, gjithashtu, në faqen zyrtare të ERE-s, në seksionin “Konsultime”, më datë 5.2.2025.

- Brenda afatit të parashikuar nuk janë paraqitur komente nga palët e interesuara. Si rrjedhojë, propozimi fillestar ka mbetur i pandryshuar dhe është vlerësuar për miratim pa modifikime shtesë.

3. Përmbajtja e ndryshimeve të rregullores

- Neni 1, shtohet: “ERE është, gjithashtu, autoriteti përgjegjës për rregullimin në sektorin e gazit natyror, bazuar në ligjin nr. 102/2015. Në përputhje me këtë ligj, objektivat e ERE-s në ushtrimin e funksioneve rregullatore janë: a) Promovimi i krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues, të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit. Sigurimi i kushteve të duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të gazit natyror, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera”.

- Nenet 2, 3, 5 (paragrafi 1, germa “b”), si dhe në nenet 6, 6/1, 7, 8, dhe 10: pas togfjalëshit energji elektrike/sistem elektroenergjetik/energjetik shtohet fraza: “dhe gazit natyror.”.

- Nenet 4, 5 (paragrafi 1) (paragrafi 1, germa “a”), (paragrafi 2), 6 (paragrafi 1, germa “d”), 6/1 (paragrafi 4), 7: kudo në rregullore, referenca për ligjin nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike” zëvendësohet me “ligjin nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”.”.

- Nenet 5 (paragrafi 2, germa “a”), 6 (paragrafi 1, gjerat “a” dhe “b”), shtojca 1: kudo në rregullore, referenca AKCESK zëvendësohet me “AKSK”.

- Neni 4, pika 6 ndryshon: ““Operator i infrastrukturës kritike të informacionit”: është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit dhe operon në sektorin e energjisë elektrike “OST” sh.a., “OSHEE” sh.a., “KESH” sh.a. dhe shtohen: “Kurum International” sh.a. – Sistemi SCADA, Dragobia



Energy – Sistemi SCADA, Prell Energy sh.p.k. – Sistemi SCADA, Power Elektrik Slabinje – Sistemi SCADA, Seka Hydropower – Sistemi SCADA, Devoll Hydropower sh.a. – Servera, switche, firewall- Sistemi SCADA, dhe Trans Adriatic Pipeline (TAP) - sistemi SCADA.”

- Në nenin 4, shtohet pika 6.1: ““Infrastrukturat e rëndësishme të informacionit”: janë persona juridikë, publikë ose privatë që administrojnë infrastrukturën e rëndësishme të informacionit dhe operojnë në sektorin e energjisë elektrike. Këto përfshijnë: “Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” (OSHEE) me *Data Center Primary, Data Center Disaster Recovery, Data Center Business Continuity*, rrjetin midis *Data Center PR, DR dhe BC*, si dhe rrjetin midis qendrës së të dhënave dhe pikave të komandimit; Termocentralin Vlorë sh.a. me Sistemin DCS; dhe HEC Vlushë me Sistemin SCADA.”.

- Neni 4, pika 11 ndryshon: ““AKSK”: është Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.”.

- Neni 5 “Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë”, paragrafi 1, ndryshon: “Rregullorja për sigurinë kibernetike në infrastrukturat kritike dhe ato të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror është hartuar bazuar në nenin 18, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në nenin 15, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, në ligjin nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, të ndryshuar.”.

- Neni 6, ndryshon emërtimi nga “Detyrime të operatorëve të infrastrukturave kritike” në “Detyrimet e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”.

- Neni 6/1, “Detyrime të tjera”; kudo në rregullore ku referohet operatorët e infrastrukturave kritike, termi ndryshon: “Operatorët e infrastrukturave kritike dhe të infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”.

- Neni 9 “Penalitetet” shtohet baza ligjore sipas ligjit nr. 102/2015, në rast se i licencuari nuk vepron në përputhje me planin e masave, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe “Rregulloren për procedurat e

vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s.

- Neni 10 “Certifikim me standardin e sigurisë ISO 27001” shtohet dhe togfjalëshi “gazit natyror”: Operatorët e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të pajisen me certifikimin me standardin e sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

- Shtohet në nenin 10, paragrafi 2: operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit, përfshirë “Kurum International” sh.a., “Dragobia Energy”, “Prell Energy” sh.p.k., “Power Elektrik Slabinje”, “Seka Hydropower”, “Devoll Hydropower” sh.a. dhe “Trans Adriatic Pipeline” (TAP), detyrohen të pajisen me certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve të rregullores.

- Shtohet në nenin 10, paragrafi 3: “Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, përfshirë “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, Termocentralin Vlorë sh.a. dhe HEC “Vlushë”, detyrohen të pajisen me certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve të rregullores.”.

- Si pasojë e zgjerimit të fushës së zbatimit në sektorin e gazit natyror, titulli i rregullores ndryshon si vijon: “Rregullorja për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë”.

4. Qëllimi i ndryshimeve

- Ndryshimet e propozuara në “Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturës kritike në sektorin e energjisë elektrike” janë të domosdoshme për të siguruar përputhshmërinë me kuadrin e ri ligjor. Këto ndryshime përfshijnë përditësimin e referencave institucionale, zgjerimin e fushës së zbatimit të rregullores në sektorin e gazit natyror, përfshirjen e infrastrukturave të reja kritike dhe forcimin e masave të sigurisë kibernetike. Gjithashtu, ato synojnë të harmonizojnë rregulloren me detyrimet kombëtare, duke përmblusur rekomandimet e Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë dhe duke siguruar një treg të sigurt dhe të qëndrueshëm të energjisë elektrike dhe gazit natyror. Një aspekt i rëndësishëm i ndryshimeve është edhe detyrimi i operatorëve për certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001, duke rritur mbrojtjen efektive ndaj rreziqeve kibernetike. Për këto arsye, miratimi i këtyre shtesave dhe



ndryshimeve është thelbësor për funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në “Rregulloren për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”.

2. Ndryshimin e titullit të rregullore dhe kudo në rregullore ndryshohen nenet 1, 2, 3, 4, 5 (paragrafi 1, gjerat “a” dhe “b”, paragrafi 2), nenet 6 (paragrafi 1, gjerat “a”, “b” dhe “d”), 6/1 (paragrafi 4), si dhe nenet 7, 8, 9 dhe 10 (ndryshimet e miratuara bashkëlidhur këtij vendimi).

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

NDRYSHIMET E MIRATUARA NË RREGULLOREN PËR SIGURINË KIBERNETIKE TË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Titulli ndryshon dhe bëhet	Rregullorja për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë	
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Neni 1	Enti Rregullator i Energjisë ka ndër objektivat e përcaktuara në nenin 18, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, promovimin dhe krijimin e një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera. ERE është, gjithashtu, autoriteti përgjegjës për rregullimin në sektorin e gazit natyror, bazuar në ligjin nr. 102/2015. Në përputhje me këtë ligj, objektivat e ERE-s në ushtrimin e funksioneve rregullatore janë: a) Promovimi i krijimit të një tregu të brendshëm konkurrues, të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit. Sigurimi i kushteve të duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të gazit natyror, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera. Bazuar në sa më sipër, ERE konsideron sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë elektrike si element themelor për ruajtjen e sigurisë dhe integritetit të sistemit elektroenergetik Shqiptar.
<i>Ndryshojnë dhe bëhen</i>	Në nenet 2, 3, 5 (paragrafi 1, gjerat “b”), si dhe në nenet 6, 6/1, 7, 8, dhe 10	Pas togfjalëshit “energji elektrike/sistem elektroenergetik/energetik” propozohet të shtohet fraza “dhe gazit natyror”.



Ndryshojnë dhe bëhen	Në nenet 4, 5 (paragrafi 1) (paragrafi 1, germa “a”), (paragrafi 2), 6 (paragrafi 1, germa “d”), 6/1 (paragrafi 4), 7	Kudo në rregullore, referenca për ligjin nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike” zëvendësohet me ligjin nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike”.
Ndryshojnë dhe bëhen	Në nenet 5 (paragrafi 2, germa “a”), 6 (paragrafi 1, gjerat “a” dhe “b”), shtojca 1	Kudo në rregullore, referenca AKCESK zëvendësohet me AKSK.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 4, pika 6	“Operator i infrastrukturës kritike të informacionit” – është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit dhe operon në sektorin e energjisë elektrike “OST” sh.a., “OSHEE” sh.a., “KESH” sh.a., “Kurum International” sh.a. – sistemi SCADA, “Dragobia Energy” – sistemi SCADA, “Prell Energy” sh.p.k. – sistemi SCADA, “Power Elektrik Slabinje” – sistemi SCADA, “Seka Hydropower” – sistemi SCADA, “Devoll Hydropower” sh.a. – servera, switche, firewall – sistemi SCADA dhe “Trans Adriatic Pipeline” (TAP) – sistemi SCADA.
Shtohet	Neni 4, pika 6.1	“Infrastrukturat e rëndësishme të informacionit” – janë persona juridikë, publikë ose privatë, që administrojnë infrastrukturën e rëndësishme të informacionit dhe operojnë në sektorin e energjisë elektrike. Këto përfshijnë: “Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” (OSHEE) me Data Center Primary, Data Center Disaster Recovery, Data Center Business Continuity, rrjetin midis Data Center PR, DR dhe BC, si dhe rrjetin midis qendrës së të dhënave dhe pikave të komandimit; Termocentralin Vlorë sh.a. me sistemin DCS; dhe HEC “Vlushe” me sistemin SCADA.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 4, pika 11	“AKSK” – është Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 5, paragrafi 1	Rregullorja për sigurinë kibernetike në infrastrukturat kritike dhe ato të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror është hartuar bazuar në nenin 18, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në nenin 15, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, në ligjin nr. 25/2024, “Për sigurinë kibernetike” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, të ndryshuar.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 6	Detyrimet e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të infrastrukturave të rëndësishme të informacionit
Ndryshon dhe bëhet	Neni 6/1	Kudo në rregullore ku referohet operatorët e infrastrukturave kritike, termi propozohet të ndryshojë operatorët e infrastrukturave kritike dhe të infrastrukturave të rëndësishme të informacionit.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 9	Në rast se i licencuari nuk vepron në përputhje me planin e masave, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107, të ligjit 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 106, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe “Rregulloren për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s.
Ndryshon dhe bëhet	Neni 10	Operatorët e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të pajisen me certifikimin me standardin e sigurisë ISO 27001, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.



Shtohet	Neni 10, paragrafi 2	Operatorët e infrastrukturave kritike të informacionit, përfshirë “Kurum International” sh.a., “Dragobia Energy”, “Prell Energy” sh.p.k., “Power Elektrik Slabinje”, “Seka Hydropower”, “Devoll Hydropower” sh.a. dhe “Trans Adriatic Pipeline” (TAP), detyrohen të pajisen me certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve të rregullores.
Shtohet	Neni 10, paragrafi 3	Operatorët e infrastrukturave të rëndësishme të informacionit, përfshirë “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, Termocentralin Vlorë sh.a. dhe HEC “Vlushe”, detyrohen të pajisen me certifikimin sipas standardit të sigurisë ISO 27001, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtyre ndryshimeve të rregullores.

KËRKESË**Nr. 502/5, datë 30.4.2025****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 875, datë 11.11.2020, ‘Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti ‘Ndërtimi i nënstacionit 400/110/20 kV, Tirana 3’”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “arë”, bazuar në pikën 4, të nenit 17 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligjin nr. 88/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2011, për projektin “Eficiencia Energjetike - Programi për Sektorin e Transmetimit të Energjisë Elektrike”, dhe ligjin nr. 84/2015, “Për ratifikimin e marrëveshjes së garancisë ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe KfW Frankfurt am Main, në lidhje me marrëveshjen e huas, në shumën 40 milionë euro, ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a. (OST), dhe KfW, në mbështetje të projektit “Eficiencia energjetike – Programi për Sektorin e

Transmetimit të Energjisë Elektrike”, në bazë të të cilave është hartuar Raporti i Vlerësimit i miratuar, bazuar në Planin e Marrjes së Tokës dhe Kompensimit LACP (RAP), sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 55,975,672 (pesëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë, nga të cilat 37,264,032 lekë i shtohen vlerës së miratuar me VKM-në nr. 875, datë 11.11.2020).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT
“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 400/110/20 kV TIRANA 3”

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i pasurisë	ZK	Nr. pasurie	Sip. e pronës (m ²)	Sip. që shpronësohet (m ²)	Çmimi i tokës (lekë/m ²)	Vlera e shpronësimit (në lekë)	Shënime
1	Qemal Metoja	Arë	2947	371/5	9,200	9,200	1,406	12,935,200	
2	Artur Xhezmi Sinanaj Ferdinand Xhezmi Sinoma	Arë	2947	371/6	9,000	9,000	1,406	12,654,000	
3	Myrteza Gjashta	Arë	2947	371/11	8,000	1,700	1,406	2,390,200	
4	Mustafa Mahmut Kupi	Arë	2947	371/12	3,450	3,450	1,406	4,850,700	
5	Aqif Maliq Sina, Shaban Maliq Sina	Arë	2947	371/13	4,039	4,039	1,406	5,678,834	
6	Aqif Maliq Sina, Shaban Maliq Sina	Arë	2947	371/14	500	500	1,406	703,000	
7	Valbona Lalaj	Arë	2947	371/15	1,500	1,500	1,406	2,109,000	Pasuria nr. 371/15, ZK 2947 ka pësuar transaksion nga z. Pietro Durim Kuqi tek znj. Valbona Flamur Lalaj me kontratë shitjeje.
8	Muhamet Abdulla Zaja	Arë	2947	371/16	5,000	5,000	1,406	7,030,000	
9	Aqif Maliq Sina, Shaban Maliq Sina	Arë	2947	371/17	261	261	1,406	366,966	
10	Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.	Arë	2947	371/18	2,000	2,000	1,406	2,812,000	Pasuria 371/18 është shpronësuar dhe likuiduar, duke pasuar me kryerjen e veprimeve nga ana e OST sh.a. për kalimin e pronës nga Jakup Kupi, në emër të OST sh.a., por kjo procedurë nuk e kufizon pronarin Jakup Kupin të marrë shpërblimin shtesë të shpronësimit.
11	Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.	Arë	2947	371/19	2,000	2,000	1,406	2,812,000	Pasuria 371/19 është shpronësuar dhe likuiduar, duke pasuar me kryerjen e veprimeve nga ana e OST sh.a. për kalimin e pronës nga Mustafa Isak Doda në emër të OST sh.a., por kjo procedurë nuk e kufizon pronarin Mustafa Isak Dodën të marrë shpërblimin shtesë të shpronësimit.
12	Fatmir Maliq Çejku, Ylber Maliq Çajku, Nexhmije Maliq Gjana, Hatije Maliq Domi, Meriman Maliq Çejku, Fitore Maliq Çela,	Arë	2947	5/1/6	14,950	457	1,406	642,542	



	Luan Maliq Çajku, Abaz Maliq Çejku								
13	Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.	Arë	2947	5/1/30	220	220	1,406	309,320	Në zbatim të VKM-së nr. 875, datë 11.11.2020, pasuria 5/1/7 është shpronësuar me një sipërfaqe prej 220 m ² , që i është marrë sipërfaqes totale prej 7000 m ² , kjo sipërfaqe (e kompensuar) prej 220 m ² ka kaluar nga Bashkim Isuf Kupi në emër të OST sh.a., e cila mban numrin e pasurisë 5/1/30 ZK 2947, ndërsa pjesa tjetër prej 6780 m ² me nr. pasurie 5/1/31 është në emër të Bashkim Kupit. Sqarojmë se pasuria 5/1/31 nuk preket, referencat për ndryshimet dhe shtesa të VKM-së nr. 875, datë 11.11.2020, janë për sipërfaqen prej 220 m ² të pasurisë 5/1/30 (ish 5/1/7), kjo e pasqyruar në plan-vendosjen e shpronësimit.
14	Isuf Jakup Kupi	Arë	2947	5/1/8	1,000	41	1,406	57,646	Pasuri e pacertifikuar – pronari i pasurisë do të likuidohet pasi të depozitohet të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor dhe të jetë pajisur me certifikatë pronësie.
15	Mustafa Mahmut Kupi	Arë	2947	5/1/9	9,950	444	1,406	624,264	
Sipërfaqe totale shpronësimi (m ²)						39,812			
Vlera totale								55,975,672	

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. “Nikolla Jorga”, Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë

